

VENDIM
Nr. 612, datë 31.8.2016

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT
E NJERIUT, DATË 7.4.2016, PËR ÇËSHTJEN “HALIMI DHE TË TJERË KUNDËR
SHQIPËRISË”
(PËR ANKIMIN NR. 33839/11)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.4.2016, për çështjen “Halimi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për ankimin nr. 33839/11, në shumën 755 150 (shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë) euro, në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror, si dhe kostot e shpenzimet, sipas listës së ankuesve në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.
 2. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, gjatë ekzekutimit të vendimit të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma në datën e kryerjes së pagesës.
 3. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.4.2016.
 4. Pagimi i shumës së depozituar, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të ankuesve në çështjen “Halimi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për ankimin nr. 33839/11, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave, nga fondi i kontingjencës i buxhetit të shtetit, brenda 3 muajve nga dita që vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.
 5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumën e mësipërme paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.
 6. Efektet financiare, të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontingjencës i buxhetit të shtetit.
 7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1
LISTA E APLIKANTËVE

Titulli i çështjes dhe aplikimi	Emri i aplikantëve (viti i lindjes)	Vendqëndrimi	Përfaqësuar nga	Paraqitja e çështjes
“Halimi dhe të tjerë kundër Shqipërisë” Aplikimi nr. 33839/11	Eni Kokona (1976)	Shqipëri	S.Puto, avokat	14 Mars 2011
	Lindita Kokona (1976)	Shqipëri		
	Xhejni Kokona (1978)	Shqipëri		
	Nirvana Rradheshi (1951)	Shqipëri		
	Shpresa Halimi (1969)	SHBA		
	Diana Kaltani Halimi (1936)	Kanada		
	Ermal Halimi (1959)	Shqipëri		
	Karolina Halimi (1935)	Shqipëri		
	Ariel Halimi (1963)	Shqipëri		